

AKTI I THEMELIMIT TË SHOQËRISË

“PRIOR GROUP” sh.p.k

Sot më datë, 07.07.2023, unë i nënshkruari:

Zj. Drita DODA, i biri/e bija e Fran, i/e datëlindjes 29/11/1988, lindur në Mirditë dhe banues në Tiranë, shpreh vullnetin për hartimin e këtij Akti Themelimi të Shoqërisë “**PRIOR GROUP**” sh.p.k si më poshtë vijon:

Zj. Davida DODA, i biri/e bija e Fran, i/e datëlindjes 21/05/1991, lindur në Mirditë dhe banues në Tiranë, shpreh vullnetin për hartimin e këtij Akti Themelimi të Shoqërisë “**PRIOR GROUP**” sh.p.k si më poshtë vijon:

1. Forma ligjore e shoqërisë

Shoqëria “**PRIOR GROUP**” sh.p.k, nga këtu e mëposhtë në këtë akt, e referuar si shoqëria, themelohet si një shoqëri tregtare në formën e “Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar”, shkurtimeisht sh.p.k.

2. Ortakët themelues

Ortakët themelues të shoqërisë janë:

Zj. Drita DODA	50%
Zj. Davida DODA	50%

3. Objekti i veprimtarisë

Objekti i aktivitetit të shoqërisë “**PRIOR GROUP**” sh.p.k do të jetë:

Veprimtaria financiare e këmbimeve valutore. Veprimtari e agjentit për shërbimin e pagesave për të tretët në emër dhe për llogari të një subjektit financiar jo bankë. Këmbim valutore, agjent për transferim parash në llogari të një subjekti financiar jobankar, agjent komisioner, aktivitetin e marketingut apo përfaqësuesit për firma të ndryshme të vendit apo të huaja.

Shërbime në fushën e turizmit, hotelerisë, shitje-blerje biletash avioni, trageti, autobusi dhe/apo të mjeteve të ndryshme, dhe të organizimit në formë të ndryshme të udhëtimeve turistike. Shitje-blerje të paketave turistike, eventeve zyrtare dhe jo-zyrtare. Organizim udhëtime Turistike apo ture me grupe të organizuara brenda dhe jashtë vendit. Shoqëria bashkëpunon me agjenci të tjera turistike, udhëtimi, shoqëri transportesh etj, vendase dhe / apo të huaja, hotele, resorte, restorante, individë, familje etj, që kanë objekt veprimtarie të njëjtë me të apo që lidhen me objektin e saj të veprimtarisë. Shoqëria do të kryej aktivitet në fushën e promovimit të turizmit vendas e të huaj, bashkëpunim me agjenci, persona juridike, fizike, individë, institucione të ndryshme shtetërore / publike / private, etj. Shitje të produkteve të agjencisë (bileta avioni, bileta autobusi, makina me

qera, transfertat, eskursione, rezervime apartamentesh dhe hotelesh, udhëtime turistike, bileta eventesh koncerte, sport, etj) ONLINE.

Aktivitet ndërmjetësimi për pasuritë e paluajtshme, agjensi imobiliare. Shoqëria mund të kryej të gjitha operacionet tregëtare mbi pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, që do të vlerësohen të nevojshme apo të dobishme për realizimin e objektit të shoqërisë si dhe të blejë pjesëmarrje në kapitalin themeltar të shoqërive të tjera që kanë objekt të ngjashëm apo të përafert me të vetin. Gjithashtu, brenda kufijve të përcaktuar nga ligji mund të lëshojë garanci, letra dëmshpërblimi dhe çdo garanci tjetër reale. Shoqëria në ushtrimin e aktivitetit të saj, do të marrë të gjitha autorizimet e lejet e nevojshme pranë institucioneve publike shqiptare, dhe do të mbështetet në rregullat dhe normat në fuqi në lidhje me ushtrimin e veprimtarisë së saj të rregullt ekonomik

4. Selia e shoqërisë

Selia e Shoqërisë “**PRIOR GROUP**” sh.p.k do të jetë në Tiranë, në adresën: Rruga “Muhamet Gjollesha”, Pallati 43, Shkalla 28, Kati i Parë, Tiranë, Shqipëri, Shqipëri.

Shoqëria mund të vendosë të hapë degë, filiale apo zyra përfaqësie në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe jashtë saj.

5. Kohëzgjatja e shoqërisë

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj, sipas objektit, për një periudhë 10 (Dhjetë) vjeçare, e cila fillon nga data e regjistrimit të saj në regjistrin tregtar.

Afati i përmendur në pikën 1 të këtij neni mund të shkurtohet apo zgjatet me vendim të asamblesë së ortakëve, në përputhje me rregullat e përcaktuara nga ky Statut.

6. Kapitali i shoqërisë

Kapitali themeltar i shoqërisë tregtare “**PRIOR GROUP**” sh.p.k është **100’000** (njëqind mijë) Lekë.

Kapitali themeltar është i ndarë në 2 (dy) kuota.

Zotërimi i kuotave nga ortakët është:

- zj. Drita Doda është zotëruesi i 1 (një) kuote të shoqërisë, në vlerën 50’000 (pesëdhjetë mijë) Lekë ose 50% e kapitalit themeltar.
- zj. Dejvi Doda është zotëruesi i 1 (një) kuote të shoqërisë, në vlerën 50’000 (pesëdhjetë mijë) Lekë ose 50% e kapitalit themeltar.

Kapitali themeltar mund të zmadhohet edhe me kontribute në natyrë.

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit themelor të **Shoqërisë** bëhet me vendim të **Ortakëve**. Fondi në të holla që vjen nga shlyerja e pjesëve të kapitalit themeltar depozitohet për llogari të **Shoqërisë** në të gjitha Bankat që ndodhen në territorin e Shqipërisë.

Transferimi i pjesëve të kapitalit themeltar bëhet me akt noterial.

7. Ortakët

Ortakët ushtrojnë kompetencat që ligji i jep sipas Asamblesë së Ortakëve.

8. Drejtimi dhe Administrimi

Shoqëria drejtohet nga Administratori.

Administratori i parë i shoqërisë “PRIOR GROUP” sh.p.k është zj. **Drita DODA**.
Administratori emërohet me vendim të Ortakëve, për një periudhë jo më shumë se 5 (Pesë) vjet.

Përfaqësimi i shoqërisë tregtare “PRIOR GROUP” sh.p.k në marrëdhënie me të tretët dhe brenda kufijve që i njej ligji dhe Statuti, i përket Administratorit të saj. Ai ka të drejtë të përfaqësoje Shoqërinë edhe në organet gjyqësore apo të ngarkojnë për këtë qëllim një zyrë avokatie në mbrojtje të interesave të Shoqërisë.

9. Shpërbërja dhe likuidimi

Shpërbërja dhe likuidimi i shoqërisë tregtare mund të vijë në çdo kohë dhe për çfarëdo shkakut ligjor, duke përfshirë dhe falimentimin, privimin për të ushtruar profesion tregtar, forca madhore, rast lufte dhe të çdo faktori tjetër që nuk varet nga vullneti i ortakëve të shoqërisë.

Themeluesit

Drita DODA



David DODA

